



Prishtinë, 27 shkurt 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_893\_2017

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

**Duke u bazuar në:**

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-788-2016 të datës 23 shkurt 2016 të lëshuar shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., me të cilën ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në lumin Radesha dhe Plava HC Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, Komuna e Dragash, Republika e Kosovës, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në lumin Radesha dhe Plava HC Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, Komuna e Dragash, të datës 20.02.2017, të shoqërisë “NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., me adresë: rruga e “Jonit” nr. 92/2 - Prizren, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 27 shkurt 2017 nxori këtë:**

## V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_788\_2016 i datës 23 shkurt 2016, i lëshuar shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., për kompletimin e aplikacionit për marrjen e Autorizimit Final, për ndërtimin e HC Dragash me kapacitet të instaluar prej **3.4 MW**, Komuna Dragash edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 23 gusht 2017**.
- II. Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., obligohet që brenda këtij afati të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në lumin Radesha dhe Plava HC Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, Komuna e Dragash, gjegjësisht deri me datën **23 gusht 2017** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur në pikën I. të diapozitivit, Vendimi V-788-2016 i datës 23 shkurt 2016 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.

## A r s y e t i m





- ZRRE, me datë 21.12.2015 nga shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në lumin Radesha dhe Plava HC Dragash, me kapacitet të instaluar prej 3.4 MW, Komuna e Dragash, Republika e Kosovës.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 23 shkurt 2016 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_788\_2016, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_788\_2016, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar disponueshmërinë e caqeve si dhe pranimin e aplikuesit në skemën mbështetëse dhe garantimin automatik të tarifës nxitëse.
- Njoftimi mbi Vendimin për Autorizimin Preliminar ka përcaktuar se aplikuesit i garantohet lidhja e Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Furnizuesit Publik në kohëzgjatje 10 vjeçare, e cila do të lidhet së paku (30) ditësh para datës së fillimit të operimit gjenerues.
- Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (1) një vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqërisë NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., do t'i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- Aplikuesi NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., me datë 20.02.2017 ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: që nga data e marrjes së vendimit për autorizimin preliminar janë angazhuar në kompletimin e dokumenteve të kërkuara (Lejen ndërtimore, Pëlqimit Ujor, Pëlqimin Elektroenergjetik kontratën për shfrytëzimin e paluajtshmërisë publike dhe private dhe të Agjencisë së Pyjeve).
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., deri më tani ka arritur të siguroj dëshmitë: Pëlqimi nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës ref. KE -809/16 dt. 30.12.2016, Kontrata për Qiranë e Tokës Pyjore nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës ref. KE -810/16 dt. 30.12.2016, Garancioni i pagesës nga NLB Banka për Komunën e Dragashit, Pëlqimin Mjedisor ref. 15/5773/1-608/DMM dt. 21.12.2016 të lëshuar nga MMPH, Pëlqimin Ujor ref. 2297-2/16 –ZSP- 2016 dt. 03.06.2016 të lëshuar nga MMPH dhe Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 3638 dt. 03.05.2016 të lëshuar nga KEDS SH.A.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., ka sqaruar se: si dëshmi e vetëm e që ju ka mbetur pa u siguruar deri më tani është Leja ndërtimore nga organi kompetent komunal të cilën shpresojmë se në pajtim me procedurat të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme do të arrijmë ta finalizojmë brenda këtij afatit të kërkuar.
- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., ka sqaruar se: pjesa e trases nëpër të cilën pritet të kaloj tubacioni për ndërtimin e këtij hidrocentrali prek edhe pronat private, është dashur që të shkohet përmes Ligjit për shpronësim e pronës së paluajtshme nga organet kompetente, ku





deri më tani kemi arritur të sigurojmë Vendimin Preliminar nga organi shpronësues i caktuar sipas këtij ligji, është mbajtur debati publik me qytetar dhe jemi në pritje të Vendimit Përfundimtar për shpronësim që do të lëshohet nga organi kompetent dhe pas marrjes së këtij vendimi do të aplikojmë për Leje ndërtimore e cila do të lëshohet brenda këtij afati të kërkuar

- Shoqëria NPN“Renelual Tahiri” Sh.p.k., ka sqaruar se: Vendimi Preliminar është miratuar për shpronësimin për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit për ndërtimin e hidrocentralit HC Dragash, me kapacitet prej 3.4 MW, ZK Dragash Komuna Dragash, sipas tabelave të përshkuara nga evidenca kadastrave përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij vendimi.
- Andaj, bazuar në këto dëshmi të cekuar si më lartë, kanë kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që të lejoj shtyerjen e afatit të vlefshmërisë së vendimit të autorizimit preliminar edhe për gjashtë (6) muaj, për kompletimin e aplikacionit dhe sigurimit të Lejes Ndërtimore nga organi kompetent komunal dhe të bëjmë kërkesë me shkrim sipas rregullores në fuqi, për marrje të Autorizimit Final për ndërtimin e Hidrocentralit HC Dragash. Gjithashtu kërkesës iu janë bashkangjitur dëshmitë e siguruara deri më tani dhe atë: Pëlqimi nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës ref. KE -809/16 dt. 30.12.2016, Kontrata për Qiranë e Tokës Pyjore nga Agjencioni i Pyjeve të Kosovës ref. KE -810/16 dt. 30.12.2016, Garancioni i pagesës nga NLB Banka për Komunën e Dragashit, Pëlqimin Mjedisor ref. 15/5773/1-608/DMM dt. 21.12.2016 të lëshuar nga MMPH, Pëlqimin Ujor ref. 2297-2/16 –ZSP- 2016 dt. 03.06.2016 të lëshuar nga MMPH dhe Pëlqimin Elektroenergjetik nr. 3638 dt. 03.05.2016 të lëshuar nga KEDS sh.a., dhe dëshmitë e lartcekura për kompletim të dokumentacionit për marrje të Lejes ndërtimore nga organi kompetent.
- ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar atë dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.


V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Dragash,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, u.d kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar